



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 07.03.2025

Nr: 12

Ora: 10:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIM E KËRKESËS ANKIMORE NR. 4, DATË 03.03.2025, DEPOZITUAR  
NGA “PARTIA ALEANCA EUROPIANE EKOLOGJIKE – AEE”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 07.03.2025, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Partia Aleanca Europiane Ekologjike – AEE, me kryetar z. Sazan Guri, e regjistruar për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, me vendimin nr. 225, datë 28.02.2025

**OBJEKT:** Ndryshimin e vendimit nr. 230 datë 28.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.05.2025”

**BAZË LIGJORE:** Neni 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

## Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 230, datë 28.02.2025, vendosi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025, si vijon:
  - 1) Stema e Republikës.
  - 2) Logo KQZ.
  - 3) Shkrimet:
    - a) Republika e Shqipërisë;
    - b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
    - c) Fletë votimi;
    - d) Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 11 maj 2025;
    - e) Qarku;
    - f) QV nr.
  - 4) Emri i subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion/ kandidat i propozuar nga zgjedhësi).
  - 5) Emri dhe mbiemri i kryetarit të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion).
  - 6) Shkronjat nistore të subjektit zgjedhor (parti politike/koalicion).
  - 7) Logo e partisë, ose koalicionit të regjistruar si subjekt zgjedhor.
  - 8) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmemërore të renditur.
  - 9) Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmemërore të cilët marrin votë preferenciale.
  - 10) Numri rendor për parti politike ose koalicionin e partive.
  - 11) Kuadrat (i bardhë) ku bëhet shënimi i votuesit për partinë, ose koalicionin.
  - 12) Kuadrat (i bardhë) ku vendoset shënimi i votuesit për kandidatët e votimit preferencial.
2. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur kërkesën ankimore me nr. 4, datë 03.03.2025, Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE, nëpërmjet të cilës kërkon ndryshimin pjesërisht të vendimit të sipërcituar.
3. Në përputhje me rregulloren “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, u hodh shorti për caktimin e relatorit për shqyrtimin e kësaj kërkesë ankimore dhe u caktua anëtari z. Ledio Braho, si relator i shqyrtimit të kësaj çështjeje.
4. Në datën 05.03.2025, KAS-i zhvilloi seancën e verifikimit të plotësisht të formës dhe përmbajtjes së kërkesës ankimore, në prani të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së dhe me përfaqësimin e personave të autorizuar, Av. Redon Meksi, Av. Altin Goxhaj dhe Av. Ili Gërdupi, për Partinë Aleanca Europiane Ekologjike.
5. Pala ankuese kërkoi që kandidatët në listën e hapur të shoqërohen me një numër identifikues pranë emrit dhe mbiemrit të tyre në fletën e votimit (pika 9 e lidhjes nr. 1). Ky ndryshim është i domosdoshëm për të garantuar integritetin dhe lehtësinë e procesit zgjedhor. Po ashtu, në seancën e shqyrtimit administrativ pala ankuese ngriti edhe pretendimin që ndryshimi i vendimmarrjes së KShZ duhet të bëhej edhe në lidhje me elementin “Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmemërore të renditur”, e cila sipas palës ankuese nuk duhet të pasqyrohet në fletën e votimit.
6. Përfaqësuesi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve parashtrori në shqyrtimin e kërkesës rrethanat e çështjes.
7. Pasi dëgjoi shpjegimet e palëve dhe përgjigjet e pyetjeve, mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën Ankimore nr. 4, datë 03.03.2025, depozituar nga Partia Aleanca Europiane Ekologjike;
- Vendimin nr. 6, datë 06.02.2025, “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025” të Komisionit Rregullator;
- Vendimin nr. 230, datë 28.02.2025 "Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

### **KAS-i konstatoi:**

8. Si fillim, është për t’u cituar se përpara vendimmarrjes së KShZ, objekt i këtij shqyrtimi administrativ, janë miratuar dy vendime të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së, më konkretisht vendimi nr. 6, datë 6.2.2025 “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025” dhe vendimi nr. 7, datë 14.2.2025, “Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”. Sipas këtyre dy vendimmarrjeve të Komisionit Rregullator janë miratuar karakteristikat teknike të fletës së votimit, për zgjedhësit me banim brenda/jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes bashkëlidhur këtyre vendimeve si dhe gjithashtu janë përcaktuar dimensionet minimale të fletës së votimit, pasi dimensionet e sakta i janë lënë në kompetencë KShZ, në varësi të numrit të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje.
9. Në vijim të këtyre vendimmarrjeve, KShZ, me vendimin nr. 230, datë 28.02.2025, “Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11.5.2025”, në zbatim të neneve 97 pika 1, dhe 98, të K.Zgjedhor, ka miratuar disa elementë përmbajtësorë të fletës së votimit sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Ankuesi Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE, nëpërmjet ankimit objekt të këtij shqyrtimi administrativ, si fillim ka kërkuar ndryshimin e vendimit të sipërcituar të KShZ vetëm sa i përket mungesës së numërtimit të kandidatëve të listave shumemërore të cilës marrin votë preferenciale (pika 9 e lidhjes nr. 1 të vendimit) dhe më tej, në seancën e shqyrtimit administrativ, kërkoi ndryshimin e vendimit edhe për sa i përket emrit dhe mbiemrit të kandidatëve në listën shumemërore të mbyllur (pika 8 e lidhjes nr. 1 të vendimit), duke kërkuar mospasqyrimin e tyre në fletën e votimit.
11. Nga analiza ligjore e çështjes, KAS-i konstaton se K.Z ka vendosur hapësirë diskrecionale për KShZ në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskrecionale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrës në zgjedhje mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por K.Zgjedhor, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KShZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me elementë si:
  - fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97 pika 1, të K.Z);
  - fleta e votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajë elemente sigurie (neni 98 pika 1, të K.Z);

- emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë/koalicionit të partive duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë/koalicionit (neni 98 pika 3, );
- çdo subjekt që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98 pika 3, të K.Z).
- fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvend duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98 pika 4, të K.Z).

Pavarësisht ndryshimit të formulës së votimit parapëlqyes me ndryshimet e vitit 2024 të K.Zgjedhor, në raport me formulën e zbatuar në vitin 2021, ligjvënësi nuk bëri amendime në nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor, dispozita këto që trajtojnë fletën e votimit.

12. E drejta e KShZ-së për të kompozuar informacionin e fletës së votimit, sidomos për sa i përket mënyrës së votimit parapëlqyes duhet të respektojë kushtet:

- informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejte i ngarkuar;
- konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin, dhe;
- zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer (neni 98 pika 4, të K.Z).

Formulimi i pikës 4, të nenit 98, të Kodit Zgjedhor, nënkupton se KShZ ka të drejtën ligjore të zgjedhë sasinë e informacionit për votimin parapëlqyes që do të përfshijë në fletën e votimit, në varësi nga nevoja për ta mbajtur fletën e votimit të thjeshtë, me konfigurim të qartë e të kuptueshëm dhe me orientim të lehtë. Të tre elementët plotësues të mësipërm, duke qenë shumë subjektiv është praktikisht e pamundur të përkufizohen në mënyrë shterruese nga pikëpamja sasiore në dispozitat e K.Zgjedhor dhe në këtë kuptim ato janë elementë të cilët ligjvënësi ia ka lënë në kompetencë t'i përcaktojë organi administrativ kompetent për miratimin e fletës së votimit. Ky është një rast tipik i lejjimit të ushtrimit të diskrecionit administrativ nga një organ publik. Diskrecioni i Komisionerit në interpretimin e elementëve përmbajtësorë në përgatitjen e fletës së votimit është dukshëm i pranuar, duke konsideruar faktin se këto elemente të kërkuara nga Kodi Zgjedhor të cilat duhet t'i plotësojë fleta e votimit, në dukje mund të përmbushen nga më shumë se një variant apo projekt i fletës së votimit, por në fund është gjykimi vlerësues i Komisionerit ai që vendos se cili nga projektet e fletës së votimit do të shndërrohet në fletë votimi të miratuar.

Në këtë kontekst, KAS, kufizohet vetëm në shqyrtimin e faktit nëse Komisioneri në miratimin e elementeve përmbajtësorë të fletës së votimit me vendimin objekt ankimi, ka vepruar në kundërshtim me kriteret bazë teknike të parashikuara në K.Zgjedhor dhe më pas nëse Komisioneri ka vepruar përtej diskrecionit administrativ që i është njohur atij nga K.Zgjedhor. Ose thënë ndryshe, KAS vlerëson nëse Komisioneri ka shkëlur ndonjë dispozitë urdhëruese të ligjit në marrjen e këtij vendimi dhe nëse ka ushtruar diskrecion të paligjshëm në miratimin e elementëve përmbajtësorë me vendimin objekt shqyrtimi administrativ.

13. Sa i përket kompozimit të fletës së votimit, interesi i zgjedhësve është interes madhor në raport me interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votimit nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve. Për më tepër,

kompozimi i saj ka ndikim të drejtpërdrejtë tek lehtësimi i procedurave të votimit e të numërimit të votave, tek ruajtja e fshehtësisë së votimit, si dhe tek ulja e rasteve të pavlefshmërisë apo të votimit të gabuar. Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë.

14. **Ankuesi Partia Aleanca Europiane Ekologjike - AEE, kërkon ndryshimin e vendimit të KShZ sa i përket mungesës së numërimit të kandidatëve të listave shumëmemërore të cilët marrin votë preferenciale (pika 9 e lidhjes nr. 1, të vendimit) dhe për sa i përket emrit dhe mbiemrit të kandidatëve në listën shumëmemërore të mbyllur (pika 8 e lidhjes nr. 1, të vendimit), duke kërkuar mospasqyrimin e saj në fletën e votimit. Pyetja që shtrohet për diskutim në këtë rast është se nëse KAS pranon kërkesën ankimore të ankuesit, a e cënon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit nga ana e KShZ, apo jemi në kushtet që ky i fundit e ka tejkaluar këtë ushtrim të ligjshëm të diskrecionit?!**
15. Më konkretisht, pika 3 e nenit 3, të K.Pr.Administrative përkufizon “*diskrecionin e organit publik*” si “*e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik*”. Ndërkohë neni 11, i K.Pr.Administrative, e sanksionon në mënyrë të detajuar parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit duke parashikuar se:

*“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:*

*a) është i parashikuar me ligj;*

*b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;*

*c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe;*

*ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.*

Pra, ligji krijon një hapësirë për alternativë vendimmarrëse për organet publike në raste përjashtimore. Organi publik duhet të respektojë dispozitat e përcaktuara në nenin 11, të K.Pr.Administrative nëse është i autorizuar të zgjedhë midis dy ose më shumë alternativave të ligjshme gjatë zbatimit të ligjit në një rast të veçantë. Në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar diskrecionin nga ana e organit publik, ato janë si vijon:

*a. Diskrecion i parashikuar me ligj (shkronja “a”)*

Dispozita e parashikuar në shkronjën “a” nuk ka të bëjë me ushtrimin e diskrecionit si të tillë, por me parakushtin e dhënies së pushtetit diskrecionar. Norma e zbatueshme duhet të analizohet nëse ajo ka dhënë apo jo diskrecion. Në shumicën e rasteve formulimi i ligjit tregon qartazi vendimin që duhet të merret. Në rast të kundërt, nëse pasoja ligjore e një norme specifike nuk zbatohet në mënyrë strikte por varet nga një “vlerësim” i organit publik që ka mundësi të zgjedhë ndërmjet zgjidhjeve të ndryshme, atëherë mund të thuhet se norma parashikon diskrecion. Pikat 3 dhe 4, të nenit 98, të K.Z, në raport më pikën 1, të po këtij neni, janë rast tipik i diskrecionit të parashikuar në ligj në lidhje me formatimin konkret të fletës së votimit sa i përket reflektimit të përmbajtjes në të. Mjafton që të plotësohen kushtet e kërkuara në këtë nen, në mënyrë që të jemi në përputhje me këtë dispozitë dhe interpretimi i nenit 98,

të K.Zgjedhor e bën të qartë faktin që elementët përmbajtësorë konkretë të fletës së votimit janë kompetencë diskrecionare e KShZ.

*b. Nuk tejkalon kufijtë e ligjit (shkronja “b”)*

Dispozita e shkronjës “b” kërkon që organi publik të sigurohet që do të marrë vendimin e tij diskrecionar brenda kufijve të pasojave juridike të ligjit. Në rastin e elementëve përmbajtësorë të miratuar me anë të vendimit objekt shqyrtimi administrativ, duket qartazi se jemi në kushtet kur vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nuk i tejkalon kufijtë e ligjit.

*c. Nuk tejkalon objektivin e ligjit (shkronja “c”)*

Dispozita e parashikuar në shkronjën “c” përbën parakushtin për ushtrimin e diskrecionit. Organi publik duhet të marrë parasysh objektivat ligjore të ligjit diskrecionar dhe duhet të orientojë vendimin drejt arritjes së këtyre objektiveve. Duke vepruar në këtë mënyrë, organi publik duhet të vlerësojë rëndësinë e objektiveve në rastin e veçantë dhe të marrë parasysh se deri në çfarë mase mund të arrihen objektivat nëpërmjet zgjedhjeve të dhëna. Edhe sa i përket këtij kushti, elementët përmbajtësorë të fletës së votimit, të miratuar me vendimin objekt i këtij shqyrtimi administrativ, nuk e tejkalojnë objektivin e ligjit, përkundrazi janë në përputhje me nenin 98 pika 4, të K.Zgjedhor. **Asnjë prej pretendimeve të ankuesit, si ai për numërtimin e kandidatëve të listës parapëlqyese ashtu edhe ai për mospasqyrimin e kandidtave të listës së fiksuar, nuk e tejkalojnë objektivin e nenit 98 të K.Zgjedhor. Edhe pasqyrimi i listës së fiksuar të kandidatëve në fletën e votimit, nuk është tejkallim i objektivit të ligjit, por konsiderohet element transparence në raport me zgjedhësin kur ai ka si alternativë disa subjekte zgjedhore në fletën e votimit dhe mund të jetë pikërisht lista e fiksuar ajo që mund të jetë vendimtare në përzgjedhjen e subjektit zgjedhor nga ana e votuesit.**

*d. Asnjë shmangie e pajustificuar në raport me rastet e njëjta ose të ngjashme (shkronja “ç”)*

Ky është një kusht i domosdoshëm për shkak të parimit të barazisë siç parashikohet në nenin 18, të Kushtetutës dhe vetë nenin 17 të K.Pr.Administrative, ku organi publik nuk duhet të përdorë fuqinë e tij diskrecionare për të trajtuar çështje të njëjta në mënyra të ndryshme pa arsye thelbësore. Sa i përket votës preferenciale të kandidatëve, edhe pse pjesërisht mund ta krahasojmë me fletën e votimit për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021, për shkak të konceptimit të formulës së votës parapëlqyese në mënyrë të ndryshme nga formula aktuale, nuk mund të them se ka ndonjë shmangie të pajustificuar, përkundrazi këto elementë përmbajtësorë i tregojnë më qartazi votesit se shpërndarja e mandateve tashmë kryhet nëpërmjet një formule të ndryshme nga ajo me renditje siç zbatohet në vitin 2021.

**Pas analizës së detajuar që i bëmë vendimmarrjes konkrete të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në raport me nenin 11, të K.Pr.Administrative që parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, arrijmë në përfundimin që elementët përmbajtësorë të fletës së votimit të miratuara me vendimin objekt shqyrtimi administrativ, janë tërësisht në përputhje me këtë parim. Ajo se çka mund të analizojë KAS në rastin objekt shqyrtimi administrativ, është vetëm kontrolli nëse janë përmbushur apo jo kushtet e nenit 11, të K.Pr.Administrative në mënyrë kumulative në përputhje me nenet 97 dhe 98 të K.Zgjedhor.**

16. Nëse i referohemi neneve 67 pikat 2 dhe 3<sup>1</sup>, 106 pika 1<sup>2</sup> dhe 117 pika 2,<sup>3</sup> të K.Zgjedhor del qartë fryma e kodit pasi kudo përmendet termi “*kandidat*”, çka do të thotë se si kandidat, me emër dhe me mbiemër, do të duhet të identifikohet edhe në fletën e votimit, ndërkohë që me ndryshimet e vitit 2024, të K.Zgjedhor lista e kandidatëve tashmë përbëhet nga dy lista: a) lista shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe b) lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Vetë ligjvënësi në ndryshimet që i ka bërë nenit 67, të K.Zgjedhor, në lidhje me listën me renditje të fiksuar të kandidatëve, ka përcaktuar se ajo paraqitet e renditur sipas rendit shifror (siç parashikohet në pikën 8 të lidhjes nr. 1 të vendimit objekt shqyrtimi administrativ), ndërkohë që në lidhje me listën që i nënshtrohet votimit parapëlqyes ka përcaktuar se renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre. **Përdorimi i numrave vetëm në listën e fiksuar dhe jo në atë që i paraqitet zgjedhësit për votimin parapëlqyes del pikërisht nga kjo dispozitë, pasi numërtimi krijon perceptimin e një liste të renditur enkas nga subjekti zgjedhor, ndërkohë që renditja sipas mbiemrit jep qartazi perceptimin e një renditjeje rastësore (alfabetike) dhe që jep kuptimin e formulës së re të votës parapëlqyese, në ndryshim nga ajo e zbatuar në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021.**
17. Të gjitha argumentet e ngritura nga ankuesi, në vlerësimin e KAS janë thjesht pikëpamje personale vlerësuese dhe krejtësisht subjektive të tyre. Pretendimi i ankuesit analizon vetëm elementët subjektivë apo diskrecionalë që Komisioneri duhet të marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së fletës së votimit, çka është e pamjaftueshme për të konkluduar në mënyrë të drejtë në paligjshmërinë e vendimit të miratimit të elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit. Sikurse rezultoi edhe nga seanca dëgjimore në KAS, nuk ekziston asnjë provë në formën e ekspertizës apo të eksperimentit konkret i cili të vërtetojë që opinionet apo argumentet e ankuesit lidhur me kriteret plotësuese apo pakësuese janë më të sakta apo më të pëlqyera nga zgjedhësit se argumentet e Komisionerit të materializuara në elementët përmbajtësorë të fletës së votimit të miratuara me vendimin objekt ankimi.
18. **Nëse KAS do të shfuqizonte/ndryshonte një vendim të Komisionerit vetëm bazuar në pikëpamjen subjektive të vlerësimit të tij dhe duke mos analizuar dhe evidentuar nëse ka shkelje të ligjit nga ana e Komisionerit, i jep vetes kompetenca të përgatisë vetë fletën e votimit, kompetenca të cilat Kodi zgjedhor nuk ia njeh.**
19. Ankuesi, një ndër argumentet ku bazoi kërkesën për ndryshimin e vendimit objekt të këtij shqyrtimi administrativ, është edhe analogjia me vendimin nr. 28, datë 30.06.2021, të Gjykatës Kushtetuese, por

<sup>1</sup> “2. Emrat në listën shumemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve të subjektit **zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror**, duke filluar nga numri një. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati. Numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën me renditje të fiksuar është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore pjesëtuar për tre. Kur nga ky pjesëtim nuk rezulton numër i plotë mandatesh, atëherë në rast se presja dhjetore si pasojë e pjesëtimit është e barabartë ose më e madhe se 0,5 lista përmbillet me numrin e plotë pasrendës, ndërsa kur si pasojë e pjesëtimit rezulton presja dhjetore më e vogël se 0,5, lista shumemërore me renditje të fiksuar e kandidatëve mbyllet me numrin e plotë pararendës.

3. Lista shumemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes nga zgjedhësit është e barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore. **Renditja e kandidatëve bëhet sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre.**”

<sup>2</sup> “1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij”.

<sup>3</sup> “2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor”.

KAS vlerëson se nuk ka një analogji mes dispozitave të K.Zgjedhor të interpretuara dhe shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese, me ato të cilat janë në shqyrtim në këtë procedurë administrative. Në rastin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese është trajtuar instituti i shpërndarjes së mandateve brenda subjektit zgjedhor, duke interpretuar konceptin e herësit në aspektin praktik të sistemit zgjedhor në vend, duke arritur në konkluzionin se “Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se pika 3, e nenit 163, të Kodit Zgjedhor, në disa zona zgjedhore me numër të vogël zgjedhësish ose me numër të ulët të mandateve, e shndërron votën parapëlqyese në të drejtë iluzore, pasi cenon thelbin e së drejtës për të zgjedhur. Gjykata çmon që pavarësisht se në çështjet e sistemit zgjedhor ligjvënësi, si rregull, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë, në rastin konkret zbatimi i herësit në praktikë, në masën e përcaktuar nga pika 3, e nenit 163, të Kodit Zgjedhor, tregoi se ishte një mekanizëm disproporcional në raport me qëllimin e tij”. **Ndërkohë në rastin objekt shqyrtimi administrativ, shtrohen për diskutim elementët përmbajtësorë të fletës së votimit dhe jo mënyra e shpërndarjes së mandateve dhe KAS, pasi shqyrtoi në tërësi këto elementë të miratuar me vendimin e KShZ, nuk konstatoi që ndonjë prej këtyre elementëve të miratuar, apo ndonjë i munguar, të sjellë efekte të tilla që ta shndërrojë votën parapëlqyese në iluzore, ndaj për KAS, vendimi i KShZ nuk ka analogji në interpretim me çështjen e referuar të Gjykatës Kushtetuese.**

20. Fleta e votimit është bërë objekt mosmarrëveshjeje edhe në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 dhe në përfundim Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 5, datë 04.04.2021, ndër të tjera është shprehur se:

*“18. Sa i përket pretendimeve të paditësit në lidhje me paligjshmërinë e vendimit nr.19, datë 03.04.2021, të KAS për ndryshimin e vendimit nr.198, datë 01.04.2021, të KSHZ në lidhje me fletën e votimit, Kolegji e gjen me vend të theksojë paraprakisht se kompetenca lëndore dhe funksionale e Kolegjit, nuk shtrihet në vlerësimin subjektiv të gjykimeve dhe vlerësimeve diskrecionale të KSHZ, të cilat nuk provohet se dëmtojnë procesin zgjedhor. KSHZ-së i është ngarkuar detyra e menaxhimit konkret të procesit zgjedhor, nga pikëpamja administrative dhe për rrjedhojë ai në ushtrimin e detyrës së tij, ka përgjegjësinë të marrë edhe vendime me karakter diskrecionar. Në nenin 12(3) të Kodit Zgjedhor është parashikuar se: “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) është organ monokratik, që ushtron kompetencat ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhëniet me të tretët.” Ndaj është krejt e natyrshme që gjatë ushtrimit të kompetencave ekzekutive, Komisioneri të ushtrojë një hapësirë diskrecioni, në kuptim të nenit 3(3) të Kodit të Procedurave Administrative i cili parashikon se: “Diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.” Si rregull Kolegji nuk mund të rrëzojë vlerësimet e KSHZ-së bazuar vetëm në hamendësime apo vlerësime subjektive të ndryshme të të njëjtave fakte, pa pasur të paraqitura prova konkrete që nxjerrin në pah shkelje ligjore të vendimeve të KSHZ-së. Natyrisht që fletët e votimit janë provë në vetvete për zgjedhjen e bërë nga KSHZ dhe KAS e Kolegji mund t'i vlerësojnë ato vetëm në drejtim të evidentimit të shkeljeve potenciale ligjore, për të cilat janë ankuar palët, e që ndikojnë rëndë në procesin zgjedhor*

...

*25. Kolegji i gjen të mbështetura në ligj të dy përmbajtjet e fletëve të votimit, si asaj të miratuar nga KSHZ ashtu edhe asaj të miratuar nga KAS, por vlerëson se, nëse nuk do të kishte të meta*



*formale (përmasat e fletës së votimit në kundërshtim me aktet nënligjore në fuqi) organet e ankimit duhej të kishin respektuar diskrecionin e Komisionerit, sa kohë që nuk provohej qartazi se zgjedhja e Komisionerit ishte në kundërshtim me ligjin dhe dëmtonte rëndë procesin zgjedhor.”.*

21. Referuar sa më sipër arsyetuar, por edhe vendimit të Kolegjit Zgjedhor, për aq kohë sa vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk cënon asnjë nga elementët e përcaktuar në nenin 98, të K.Zgjedhor, KAS arrin në përfundimin që kërkesa ankimore objekt i këtij shqyrtimi administrativ është e pambështetur në ligj dhe në prova.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe 143, pika 1, shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

### **VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 4, datë 03.03.2025, të Partisë Aleanca Ekologjike – AEE; dhe
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 230, datë 28.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi miratimin e disa elementëve përmbajtësorë të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11.5.2025”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në nenin 145, pika 1, të K.Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot, më datë 07.03.2025

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Iirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar (Pjesërisht kundër)</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

## Mendim Pakice

Duke qenë dakord me arsyetimin e shumicës, sa i takon trajtimin të kërkesës për ndryshimin e pikës 9, të lidhjes nr. 1 të vendimit të Komisionerit nr. 230, datë 28.02.2025, më duhet të distancohem nga shumica për kërkesën për shfuqizimin e pikës 8, të kësaj shtojce. Unë gjykoj se, kërkesa e ankuesit për shfuqizimin e kësaj pike është e drejtë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 98, të Kodit Zgjedhor. *“Emri dhe mbiemri i kandidatëve në listën shumëmbërore të renditur”* (emrat e listës së mbyllur) nuk i shërbejnë procesit të votimit, sa kohë që zgjedhësi nuk voton për asnjërin nga kandidatët e kësaj liste dhe përfshirja e tyre komplikon përmbajtjen e fletës së votimit, e rëndon atë me informacion të panevojshëm për zgjedhësin dhe rrezikon të krijojë konfuzion tek votuesit.

Fleta e votimit është dokumenti zgjedhor, i cili shërben për të fiksuar vullnetin e votuesve në zgjedhje. Fleta e votimit materializon votën. Si e tillë, ajo bëhet për zgjedhësit dhe në shërbim të zgjedhësve.

Fleta e votimit duhet të përmbajë elementë sigurie që garantojnë integritetin dhe fshehtësinë e votimit, kurse formatimi i saj duhet të sigurojë qartësinë dhe lehtësinë më të lartë të mundshme për zgjedhësit që votojnë. Kodi Zgjedhor kërkon që *“informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer”* (pika 4, e nenit 98, të Kodit Zgjedhor).

Këto kërkesa ligjore përbëjnë alfën dhe omegën e rregullave për kompozimin e fletës së votimit. Këto rregulla nuk kanë lidhje me taktikat elektorale të subjekteve zgjedhore, nuk i shërbejnë komoditetit të tyre, nuk synojnë përshtatjen e fletës së votimit me mesazhin elektorale të momentit, dhe as përcjelljen e tij tek zgjedhësit, sidomos nuk ndjekin qëllimin që një apo disa subjekte elektorale të projektojnë avantazhe të padrejta zgjedhore ndaj konkurrentëve, nisur nga sjellja habituale e zgjedhësve.

Fleta e votimit duhet të jetë neutrale ndaj interesave të konkurrentëve në zgjedhje.

Informacioni që përmban fleta e votimit duhet të mbahet në minimumin e mundshëm të tij, aq sa është e nevojshme për hedhjen e rregullt të votës dhe për shprehjen e qartë të vullnetit të zgjedhësit. Këtij qëllimi i shërben përcaktimi i elementëve përbërës të domosdoshëm në fletën e votimit, të cilat janë përcaktuar shprehimisht nga Kodi Zgjedhor. *“Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi”*, përcakton neni 98, i Kodit Zgjedhor, në pikën 3 të tij.

Pastaj vjen hapësira e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend. Mënyra e organizimit të kësaj hapësire dhe informacioni i pasqyruar në të janë diskrecion i KQZ-së dhe varen nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje. Por ky diskrecion nuk mund të vijë ndesh me direktivën primare: fleta e votimit duhet të mbahet e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme. Informacioni i përcjellë nga fleta e votimit duhet të mos jetë tejet i

ngarkuar, konfigurimi i fletës duhet të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi duhet ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.

Në këtë zgjedhje, zgjedhësi do të hedhë dy vota, votën për subjektin zgjedhor, parti ose koalicion, si dhe votën për kandidatin e preferuar në listën parapëlqyese (të hapur) të subjektit të preferuar. Të dy këto komponentë janë pasqyruar mjaft qartë dhe kuptueshëm në modelin e fletës së votimit që është konceptuar për këto zgjedhje. Por zgjedhësi i është vënë në dispozicion dhe një komponent shtesë, një komponent me të cilin ai nuk mund të ketë ndërveprim, komponenti që përmban emrat e kandidatëve të listës së mbyllur të secilit subjekt në zgjedhje. Zgjedhësi nuk voton për asnjërin nga këto kandidatë. Emrat e tyre formojnë informacion të tepërt, i cili tërheq vëmendje të panevojshme, shpërdoron kohën e nevojshme për votim, çorienton votuesin dhe ngatërron votimin në atë masë, sa që mund të shkaktojë pavlefshmëri të tij në komponentin parapëlqyese, ose edhe në votën për subjektin zgjedhor, parti ose koalicion.

Administrata e KQZ-së arsyetoi para KAS-it se ky informacion bëhet për transparencë. Ky justifikim nuk është as bindës, as legjitim.

Së pari, për nevojat e mbajtjes thjesht të votimit parapëlqyese është preferuar të hiqet numri përbri emrit të secilit kandidat të listës parapëlqyese. Ky veprim është i drejtë. Renditja me numër konsektiv ngjitur e kandidatëve të listës parapëlqyese është kontradiktë në vetvete dhe kundërproduktive. Qëllimi i kësaj liste është që renditjen t'a përcaktojë zgjedhësi nëpërmjet votimit. Nga konfigurimi i këtij komponenti të fletës së votimit, zgjedhësi duhet të marrë mesazhin, se këtu nuk ka kandidat të parë, të dytë apo të fundit. Kandidati i parë është kandidati që votohet nga zgjedhësi.

Së dyti, përsëri për nevojat e mbajtjes thjesht të votimit parapëlqyese është preferuar që në listën e koalicioneve të mos vendosen shkronjat nistore të partisë, së cilës i përket kandidati. Kjo e dhënë është e dhënë e rëndësishme për orientimin e zgjedhësit përgjatë listës së kandidatëve, me gjasë mund të formojë motiv thelbësor për zgjedhjen e tij. Nëse kjo e dhënë e dobishme për votimin është lënë jashtë informacionit të fletës së votimit, atëherë nuk ka asnjë justifikim pse të jepet në një hapësirë të konsiderueshme të fletës, e dhëna për përbërjen e listës së mbyllur, kur kjo e fundit nuk shërben për votimin.

Së treti, transparenca e procesit dhe informimi i zgjedhësve për ofertën në emra të përveçëm të partive apo koalicioneve konkurruese mund të sigurohet lehtësisht me mjete dhe rrugë të tjera informimi, pa dëmtuar procesin e votimit. Listat e kandidatëve mund të afishohen në mjediset jashtë qendrës së votimit. Faqja e internetit e KQZ-së mund të bëjë një punë shumë të mirë për përhapjen e këtij informacioni. Zgjedhësve mund t'u dërgohet informacion i printuar dhe, nëse është e mundur, në format elektronik për listat e kandidatëve të subjekteve zgjedhore. Transparenca në këtë formë nuk dëmton votimin. Transparenca në formën e parashikuar nga pika 8, e lidhjes 1, të vendimit të Komisionerit nr. 230, datë 28.02.2025 dëmton votimin.

Së fundi, kjo lloj “transparence” bie ndesh me qëllimin, për të cilën bëhet votimi. Duke futur një komponent në fletën e votimit, i cili bie haptazi ndesh me direktivën primare (fleta e votimit duhet të mbahet e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme), rrezikohet që të turbullohet dhe bëhet i paqartë apo

kontradiktor vullneti i zgjedhësve në fletën e votimit. Ky informacioni i panevojshëm ngatërron zgjedhësit, një pjesë e konsiderueshme prej të cilëve, me gjasë, do mendojnë se duhet të votojnë kandidatët e listës së mbyllur, në vend të kandidatëve të listës parapëlqyese, ose, mund të votojnë edhe këta edhe ata. Me gjasë, për këtë shkak, do të ketë ulje të votës parapëlqyese dhe rritje të pavlefshmërisë në votim.

Për këto arsye jam për pranimin e kësaj kërkesë të ankuesit dhe për shfuqizimin e pikës 8 të lidhjes 1 të vendimit të Komisionerit nr. 230, data 28.02.2025.

**Ilirjan Rusmaili** - **Anëtar**